



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4630 prot.

Gramsh, më 28/11 /2022

VENDIM

Nr. 96 datë 31/10/2022

MBI

PROPOZIMET PËR STATUSIN E DËSHMORIT TË ATDHEUT

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës **31.10.2022**, pasi shqyroj raportin e Komisionit Këshillimor, me objekt “Propozime për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, bashkëngjitur dhe dosjet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr.109 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut” neni 11, në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1, shkronja (b) si dhe neni 54 shkronja (m) dhe Rregullorja e Brëndshme e Funkcionimit të Këshillit Bashkiak neni 47:

V E N D O S I:

1. Të propozojë shpalljen Dëshmor i Atdheut dhe njohjen e Statusit të Dëshmorit ë Atdheut për të ndjerin Zyber Mehmet Rabo i rënë në Luftë për mbrojtjen e Shkodrës, në luftimet e zhvilluara në Bërdicë (te ura e Baçallokut).
2. Të propozojë shpalljen Dëshmor i Atdheut dhe njohjen e Statusit të Dëshmorit ë Atdheut për të ndjerin Nexhip Rexhep Salla i rënë në Luftë për mbrojtjen e Shkodrës, në luftimet e zhvilluara në Bërdicë (te ura e Baçallokut).
3. Të propozojë shpalljen Dëshmor i Atdheut dhe njohjen e Statusit të Dëshmorit ë Atdheut për të ndjerin Arif Sali Toska i rënë në Luftë për mbrojtjen e Shkodrës, në luftimet e zhvilluara në Bërdicë (te ura e Baçallokut).
4. Të propozojë shpalljen Dëshmor i Atdheut dhe njohjen e Statusit të Dëshmorit ë Atdheut për të ndjerin Pasho Laze Braho i rënë në Luftë për mbrojtjen e qytetit të Shkodrës nga forcat Malazeze.

5. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Komisionit Qëndror për Statusin “Dëshmor të Atdheut”, Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI



Kryetari i Këshillit të Bashkisë

GRETA LENA



Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: G.Lena
Miratoi: G.Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: RHK